

KHTIMI NE KOSOVE

Intervju me te Kthyeritn nga Austria

Perpilugar nga Naser Palushi

Projekt nga:

ECRE

EUROPEAN COUNCIL
ON REFUGEES AND EXILES

CONSEIL EUROPEEN
SUR LES REFUGIES
ET LES EXILES

asylkoordination österreich



Supported by the
European Refugee
Fund

Perberja

Rikthimi ne kosove eshte projekt qe rrjedhe nga ECRE (komitetit europjan per refugjat dhe emigrant) u realizua dhe u hulumtua nga organizata Asyl koordination me seli Vjen. Ne do te mundohemi ne menyre te shkurtur tua prezentojm rezultatet e punes sone, mendimet dhe rezultatet jan te nxjerrura direkt nga te intervjuarit . Emrat e te intervjuarve nuk doti permendim pasi qe ne kete menyre jemi marrur vesh me te intervjuarit si dhe per shkak te ligjit mbi mbrojtjen e te dhenave personale. Mirpo per gjdo informat lidhur me Temen ju jemi ne dispozicion direkt tek organizata qe ishte bartese e keti projekti e cituar me lart. Nga e ter materja e perpunuar kemi nxjerru disa pika me interesante qe sherbyen si objekt i punes sone dhe njeherit jemi te mendimit se me se miri e pasqyrojn resultatin e punes si dhe reflektojn Temen ne te cilen kemi punuar.

1. Nevojat dhe Jeta e Perditshme e te Rikthyerve
2. Vendosja per tu Kthyer serish ne Vendlindje
3. Ndhma per tu Rikthyer
4. Mbas Rikthimit
5. Situata e tanishme ne Kosove
6. E ardhmja

Hyrja

Rikthimi ne Kosove eshte projekt qe rrjedhe nga ECRE (komitetit europjan per refugjat dhe emigrant) u realizua dhe u hulumtua nga organizata Asyl koordination me seli Vjen.

Nje projekt hulumtues i till u zhvillua paralel ne te gjitha shtetet Europjane , me Komunitete te ndryshme dhe kishte per qellim te ndris e pasqyroj si dhe ta definoj kthimin vullnetarisht te personave qe vendosin te kthehen ne vendlindjet e tyre.

Projekti filloj ne shkurt te vitit 2004 dhe perfundoi ne shkurt te vitit 2005, gjat kesaj perjudhe nje vjeqare u hulumtua e u diskutua me refugjatet dhe emigrantet Kosovar si dhe shoqatat e grupimet e ndryshem qe gjinden ne teritorin Austriak, ne rajonet e ndryshme si ne; (Wien,Baden,Ebresdorf,Salzburg,Graz dhe Linz,) po ashtu dhe gjat perjudhes dhjet diteshe ne Kosove me organizatat Internationale dhe ato Nazionale si dhe personat te cilet ishin khyer apo deportuar nga shtetet e ndryshme Europjane posaqerisht nga Austria per ne Vendlindjen e tyre gjegjsist pra ne Kosove.

Gjat ketyre hulumtimeve nxorem ne drite se rikthimi eshte nje Tem shume e komplikuar teme e cila eshte e ngusht e lidhur me shum faktor te ndryshem qe japin dhe ija ndrrojn rrjedhen keti Fenomeni.

Nga intervjut e zhvilluara nese i lexoni e veshtroni me vemendje ateher dote vini ne perfundim e dota krijoni mendimin e juaj personal lidhur me ket tem. Nga keto familje qe kishin vendosur te kthehen vullnatarisht ne Kosove, shkaqet dhe faktoret qe i shtyen te kthehen jan te ndryshme.

Edhe pse ne raste te shumta nuk ishte menduar lidhur me konsekuencat (nga te dyja palet) e qe pasojat ishin te pa korigjueshme, pasoja te cilat shkonin ne disfavor te te Rikthyerve. Paknaqsia me trajtimin perkujdesjen ishte shume e madhe e deshprimi i te intervjuarve ishte i pa mase.

Me detalisht dote mundohemi tua sqarojm permes Tabeles qe vijon me poshte:

Emri moshë	Ne –A-deri	shkaku ishte	Informata dhe ndihma	Me vet deshir
Z.I. 40, amvisë Ferizaj	5/99-3-01	perfundim i lejes qendrimit, dëshira e prindërve dhe e pes femijëve	gjendja e shtëpisë u vlersua nga qeveria e A(kthimi i pamundur)rindertimi 50% i shtëpisë me ndihëm te qeverisë	jo
D. I. 15, Ferizaj i papun	5/99-3/01	perfundimi i lejes se qendrimit		jo
z. B.A diku 40 Gjilan Ndermarrje ushqimore	5/99-9/99	Perfundimi i Luftës	informatat lidhur me vllaun,rindertimi i shtëpisë dhe lokalit kryesisht me mjete të veta financiare	po
Z.B.25, Gjakovë i pa pun	12/03-8/04	Fejesa në Suedi u kthye në Kosovë në mënyrë të organizuar	informatat nga familja kthimi u organizua nga Caritasi	po
Z.A.A,37 Pejë	01/96 01/97	refuzimi e kerkesës për Azil /friga nga burgu	u kthye prapë ilegal në Kosovë dhe vendosi të ndihmojë UÇK në shkaku të pa perspektives	jo
Znj.S/Prizren puntore në pompë të benzinit	96	babai në luftë ka vdekur, familja vetem	info nga familja kthimi nga u organizua nga Caritasi	po
Znj.Q.32 Prishtinë përkthyesë	94/99	i fejuari ju bashkëgjithë UÇK se 6 vite	mbas luftës kontakti i parë me familjen me vetë iniciativë është kthyer pa asnjë ndihëm	po/jo shkojë mbas dëshires se të fejuarit
Znj.K,56,Ferizaj mesuesë	5/99-12/99	në A pa status Kerkesa për asil negativ	ndihma financiare, renovimi i banesës	jo
Z.K(djali)27 Ferizaj,student kamarjer	5/99-12/99	perfundimi i Luftës, Kerkesa për asil negativ	shqynjim që A e refuzoj kerkesën edhe pse babai i semur	jo

Nevojat dhe Jeta e Perditchme e te Rikthyerve

Shumica e njerzve jan te paknaqur dhe ballafaqohen edhe me tutje (5 vite mbas Luftes) me probleme te ndryshme thuaja te pa perballushme si papunsia, varfria pa siguria si dhe furnizim jo i mjaftushem ne sektorin shendetsor e faktoret e tjer si kriminaliteti qe e ben jeten e perditchme shume te veshtir .

Policia dhe Trupat internazionale akuzohen nga qytetaret per mos angazhim te permisimit te rendit dhe qetsis publike organet e UNMIK- ut i ndjekin dhe mbrojn edhe me tutje konceptet e tyre politike, policia Kosovare nuk eshte e paisur me kompetenca te cilat dote ju mundsonin kryerjen e detyrave, rritja e kriminalitetit problemet e narkotikve prostitucionin dhe mbrojtjen e femijve nga bandat e kriminaliteti i organizuar.

Si pershembull Z. A. i cili mirret me veprimtarin e biznesit ne sektorin ushqimor qe thote: “nuk e di se qka eshte sot me se mir ne Kosove te jeshe i varfer e te luftosh per egzistenc apo te keshe nje pasuri te madhe dhe te kesh frik”, qe te dyjat jan vdekjeprurse per njeriun dhe familjen e tij ne Kosove mirpo vazdhon Z.A.” shpresoj se se shpejti dote vije dita kur sdo te kemi frike edhe pse jemi te pasur e nuk dote shetisim me arm e truproje neper vedlindjen tone te dashur Kosoven”.

Ne pyetjen se si e qmoni situaten e tanishme ne Kosove? “Katastrofale” pergjigjet zotri A. Gjat bisedave te zhvilluara me njerzit eshte per tu vrejtur se te Rinjet e shofin dhe e qmojn situaten me ndryshe se njerzit e Moshuar, nje numer i madh i te Rinjeve nuk kan kurrfar shprese se ne te ardhmen dote ndrroj diqka positive ne Kosove ndersa pjesa tjeter si dhe njerzit qe kan jetuar me gjat ne Kosov jan optimist se se shpejti do te ndrroj situata ne aspektin pozitiv per ta, ku dote permisohet situata politike e Ekonomike dote hapen vende te punes si dhe deshirojn e shpresojn ne investicionet nga firmat dhe personat nga shtetet e jashtme.

Vendosja per tu Kthyer serish ne Vendlindje

Te gjith personat e intervjuar ishin te mendimit se deshira e tyre nuk ishte per tu kthyer! por ata ishin te detyruar e te mashtruar nga organizatat dhe nga organet e shteteve ku ishin ata- gjegjesisht pra ne Austri, te gjith dote rrishin atje sikur te kishin pasur ndonje mundesi tjeter perveq kthimit, leja e tyre e qendrimit nuk u vazhdua! ilegal per te jetuar ne ato shtete (Austri) nuk ishte e mundshme, shumices prej atyre nuk ju ofrua kurrfar ndihme financiare apo ndonje form tjeter ndihme apo perkrahje perveq se asaj morale.

Ne shumicen e rasteve njerzit ballafaqoheshin me probleme te cilat nuk mundeshin ti merrnin me Mend si pershembull zotriu ishte derguar ne organin pergjegjes per Asyl pran Ministris se punve te Brendshme (Bundesasylamt) ai nuk mundi te jap Deklaraten shkaku qe perkthyesi ishte per gjuhen Serbe e zotriu nuk e fliste kete Gjuh dhe kishte ikur nga dhuna Serbe, ndersa punetori zyrtar ishte i ofenduar dhe nuk ishte ne gjendje ta kupeton kete se si zotriu si qytetar i Serbis nuk ishte ne gjendje ta kuptoj gjuhen zyrtare shteterore Serbe. Zotri B. thot: “thuaja u binda se kerkesen per Asyl e paskena shtruar ne Serbi e jo ne Austri”.

Shpesh ankoheshin te intervjuarit se shume kohe kishin humbur ne Austri pa ber asgje pa pas ndonje mundesi tjeter pershembull pe te mesuar ndonje zanat apo per te punuar pagez diqka. Gjithashtu edhe per te studjuar ishte veshtir edhe pse disa nga ata kishin perfundu studimet ne Kosove, ketyre u njiheshin shum pak provime nga Universiteti i Prishtines ne kete menyra ua veshtersonte mundsin per tu kyq ne ndonje Universitet ne Austri.

Ndihma per tu Rikthyer

Perkrahja e perkujdesi nga organizatat humanitar ne rastin tone ishin shume te vogla thuaja gati fare. Askush nuk e ditke se cila organizat kshillon per tu rikthyer, informacionet pothuaja ishin gati xerro e vetmja organizat qe u permendke e cila dotna ndihmonte te kthehemi ishte Caritasi (e me duket se keshillat e caritasit ishin ashtu siqe deshirojke Ministrija se punve te Brendshme) e cila u ndihmonte ne organizimin per tu kthyer apo me von ne renovimin e shtepive, banesave si dhe deri diku edhe me mjete financiale.

Nga te intervjuarit gjithmon potencohej deshira e investimit nga investoret e jashtem ne Kosove, tek disa ishte podhuaj shpresa e vetme per te adhmen e tyre. Mir po nga bisedat e metutejshme prap se prap vinin problemet te cilat i pamundsoj investimet dhe zhvillimin e Kosoves, si kriminaliteti, pasiguria, korupcioni, si dhe vlerat e ulta morale tek shtresat e ndryshme te popullates Kosovare e qe fatkeqsisht, ky fenomen e ben te pamundur qe edhe vet shqiptaret e sidomos ata te diaspores qe me eksperienzen dhe kapitalin e tyre te fillojn ndonje veprimtari ne Kosove apo ti perkrahin ne aspekte te ndryshme bashkvendasit e tyre Kosovar. Letsimet ne sektorin tatimor per investoret dhe veprimtarit e ulta e te mesme ne sktorin ekonomik kishte me qen nje hap i menqur ne krijimin e vendeve te punes per te Rinjet e qytetaret e Kosoves, hap i cili dote ushqej shpresat se dot ket nje te ardhme si e endrrojn vete Kosovaret.

Rasti i studentit K. I cili kishte nevoje per nje Burs ne menyrr qe ti perfundoj studimet, sikur te mos i perfundojke studimet ateher me siguri do te provonte fatin e ti ne perendim, nje fat i till ju kercenohet edhe shume e shume te Rinjeve te tjer ne mbar Kosoven.

Praktike shume e tmerrshme nga firmat dhe veprimtarit e tyre ne Kosove ku nxenesi i cili meson profesionin (zanatin) duhet me pagu pronarin e firmes, ne vend

qe ai te paguhet per punen e ber, kjo praktik duhet ne te ardhmen me iniciativen e politikajve Kosovar te ndrrohet ne favor te nxenseave.

Mbas Rikthimit

Te gjithë shprehen deshiren qe edhe mbas kthimit ne Kosove te kene kontakte me organizata te cilat jan aktive ne Kosove .

Per refugjatet te cilet u kthyen ne Kosove asnje organizat humanitare nuk u perkujdes, ata ishin te detyruar te kujdesen vete per egzistencen e tyre.

Te kthyerit nga Austri edhe pse i kaluan disa muaj apo edhe vite mbas kthimit ne vendlindje pa kurrfar veshtersi ju kthen pasuris se tyre te patundeshme. Shtepit dhe banesat e tyre nuk ishin uzurpuar (perveq se plaqkitur) nga te tjeret !

Lidhur me problemet me organet qeveritare shtetore ne Kosove pas rikthimit nuk ka informacione se a kan pasur problem apo veshtersi te natyres se ndryshme.

Shumica tregojn se te afermit e tyre nuk ju besonin se jan kthyer thuaj pa as gje apo me shume pagez, pasi qe ata ishin te bindur se ne Austri ka para dhe njerzit jan te pasur! Pra fatkeqsisht deshira qe nga Austria te kthehen pa problem e te pasur nuk u realizua! Njerzit perkundrazi ishin shume te zhgenjyer.

Situata e tanishme ne Kosove

Ne momentin e tanishem kemi te bejm me nje situat apsolutisht te rend e konfuze, situat e cila e ben jeten e pasigurt ne gjdo lemi ! Gjdo dite kemi te bejm me vjedhje kidnapime, lendime trupore e delikte te ndryshme e qe shkojne thell nen lekuren e qytetarve te Kosoves.

Te gjith Tregtaret jan te detyruar ti sigurojn lokalet e tyre! qka dote thot per ta pune 24 ore ne Dite, te tjeret si pronaret e pompave te benzinit apo Argjentaret e ata qe nuk dojn te rrezikojn jeten e tyre angazhojn firma te cilat jan te specializuara per ti mbrojt dhe siguruar.

E ardhmja

Te gjith te intervjuarit shqiptar e shofin te ardhmen e Kosoves si nje shtet i pavarur. Gjith jan te brengosur se qka dote sjelle e ardhmja te gjith presin sqarimin perfundimtar te statutit te Kosoves, para se gjitha te Rinjet jane shume te pa durushem e jane te mendimit se shume ka zgjat e po zgjat deri sa te vendoset statuti perfundimtar. Edhe pse shumica prej njerzve nuk jan optimist se zgjedhja e statutit te Kosoves dot mundesoj nje zhvillim Ekonomik me te shpejt, qe per ta eshte thuaja e vetmja shprese per ta lulezuar jeten e tyre te veshtir.

Njerzit deshirojn pune e cila dota ngriste nivelin e standartin jetsor te tyre ne nje perjudh te shkurter mirpo nje koncept i till ekonomik e strategjik mungon ose deri me tani nuk iu eshte proklamuar qytetarve te Kosoves. Nga te intervjuarit shumica prej tyre si ata ne Kosove po ashtu edhe ne Austri shprehin mllefin e paknaqsin e tyre me inteligjensin Kosovare e cila sipas tyre gjat kesaj perjudhe ose kan deshtuar apo jan korruptuar nga organet e politikajt intenational e ata national shumica nga ata jan ngujuar ne egoizmin e bajrakarizmin e tyre duke mos tentuar sinqerisht qe me punen e idet e tyre te ndimojn popullaten Kosovare qe e ardhmja e femijeve tan e te tyre sidhe ajo e Kosoves te mos ngec.

Politikanet tane kan harru se nuk eshte interesant emer e karjer (te rrejshme) me kriju por ate qka e premton duhesh edhe ta realizosh ne ndonje form. Kete e kisha prite me se shumti edhe prej atyre politikajve qe edhe vet kan qene me vite refugjat ne Austri, thote Z.A. Shumica nga ta flasin e flasin problemet edhe me tutje nuk

zgjidhen, si nuk turprohen te kandidohen edhe me tutje, kur e shofin se rezultati i arritur eshte veq turpi i tyre shprehen shume te te intervestuarit.

Problemet me te cilat ballafaqohen Kosovaret jan te natyres se ndryshme si problemi i pensioneve, i arsimit, i perkujdesit shendetsor si dhe ambientit, komunikacionit etj. Pothuaj se asnje lami ne Kosove nuk eksiston. E cila nuk ka nevoje per reforma (hulumtimet shkencore, sektori energjetik, mbrojtja e konsumatorve, poziten e gruas ne shoqirin Kosovare, sigurin dhe mbrojtjen sociale e personave me temeta psikike e fizike e mbi te gjitha koncepti dhe definimi i Njeriut si pasuri e siguri per te ardhmen e Kosoves).

Nga te gjith te intervjuarit fituam bindjen se u kthye pa deshiren e tyre te gjitha informatat qe ua prezentuan mbas perfundimit te luftes me qellim qe te kthehen ne Kosove ishin te pa saketa. Ne momentin e arritjes se te kthyerve ne Kosove askuj me nuk i interesoj lidhur me e fatin e tyre .